



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



foto: Olsi Shehu/AA

Tiranë, më 18 Mars 2022

## RAPORT I VEÇANTË MONITORIMI

**Verifikimi i respektimit të standardeve mbi procedurat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit në flagrancë të disa shtetasve, pjesëmarrës në protestat e realizuara për rritjen e çmimeve, në datat 9-10 Mars 2022**

**Autor:**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr.Brigada VIII, Pall. Teknoprojekt, Ap.10, Kati 6,  
Kuti Postare 1752

[www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

17 Mars 2022

## RAPORT I VEÇANTË MONITORIMI

**Verifikimi i respektimit të standardeve mbi procedurat e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit në flagrancë të disa shtetasve, pjesëmarrës në protestat e realizuara për rritjen e çmimeve, në datat 9-10 Mars 2022**

Në përmbushje të misionit për garantimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve, ekipi i autorizuar i vëzhguesve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), ndërmori më datë 11 Mars 2022, një mision verifikimi pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Komisarariatit Nr. 3 (Rruga Mine Peza) dhe Komisarariatit Nr. 5 (Kamëz).

Objekt i monitorimit ishte respektimi i standarteve nga policia e shtetit sa i takon shoqërimit, ndalimit apo arrestimit në flagrancë të disa protestuesve që demonstuan gjatë datave 9-10 Mars 2022, kundër rritjes së çmimeve të hidrokarbureve dhe çmimeve të produkteve të tjera të konsumit (si ato të shportës), të papërbalueshme për kushtet sociale-ekonomike të shtetasve në vendin tonë.

Metodologjia e ndjekur për verifikimet në terren përmbledhi kqyrjen e praktikës së dokumentave të institucioneve vendore të policisë së shtetit, intervistat me përfaqësuesit e deleguar të institucioneve të monitoruara, si dhe intervistat me protestuesit, liria e të cilëve ishte kufizuar në ambientet e këtyre institucioneve, duke përfshirë edhe kqyrjen pamore të këtyre ambienteve. Gjithashtu, KShH ka ndjekur indicjet e bëra publike në lajmet e përditësuara në median elektronike dhe atë të shkruar lidhur me mbulimin e pjesshëm të ngjarjeve në këto protesta.

Në përputhje me memorandumun e bashkëpunimit që KShH ka me Policinë e Shtetit e cila garanton akses të pakushtëzuar të vëzhguesve të KShH-së për monitorim në dhomat e sigurisë së Komisariateve dhe Pikat e Kalim Kufirit, saktësojmë se vërejtjet, mangësitë, problemet e konstatuara bashkë me rekomandimet e KSHH-së do të përcillen zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe strukturave përgjegjëse vendore. Nëse nga kjo korrespondencë, do të rezultojnë fakte apo të dhëna plotësuese që janë të rëndësishme sa i takon konkluzioneve të këtij raporti, materiali do të azhornohet dhe ri-publikohet në faqen zyrtare të KShH-së, duke nënvizuar në mënyrë të kuptueshme për publikun, shtesat dhe/ose ndryshimet përkatëse.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## Përmbledhje Ekzekutive

Disa nga gjetjet dhe konstatimet kryesore të këtij monitorimi, të cilat konkretizohen në pjesën shtjelluese të këtij raporti, janë si vijon:

Gjatë verifikimit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe në Komisarariatet e Policisë nr. 3 dhe nr. 5, vëzhguesit e KShH-së konstatuan se nuk ishte shënuar në dokumentacion shkaku ligjor i shoqërimit të protestuesve, konform kërkesave të nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Si shkak i shoqërimit në procedurat e dokumentuara në këto institucione ishte vendosur “Protesta dhe/ose Bllokim rruge”, fakt që bie në kundërshtim me procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Gjithashtu, shoqërimi/arrestimi në flagrancë për shkak të protestës, sikurse është reflektuar në disa raste në regjistrat e kqyruar nga vëzhguesit, bie ndesh dhe është në shkelje me garancitë e të së drejtës së tubimit, të parashikuar në nenin 47 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 11 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

KShH ka vërejtur se pas arrestimeve në flagrancë, disa protestues janë transferuar nga punonjësit e policisë së Komisariateve nr. 1, 2 dhe 3, pranë Komisariateve të Policisë Elbasan, Kavajë apo dhe Kamëz. Përligjia e transferimit për shkak të mungesës së hapësirave dhe kushteve të kufizuara infrastrukturore të Komisariateve që kanë bërë pritjen e parë të tyre, vështirëson dokumentimin e saktë kronologjik dhe rrjedhimisht edhe verifikimin e veprimeve procedurale që ndërmerren ndaj dhe në ngarkim të tyre, duke rritur premisat për abuzivitet dhe mosrespektim të standarteve procedurale të kërkuara për kufizimin e lirisë së shtetasve, sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për disa nga protestuesit e shoqëruar është bërë arrestimi i tyre në flagrancë disa orë pasi janë shoqëruar në ambientet e policisë. Ky fakt ngre pikëpyetje serioze për mosrespektimin e gjendjes së flagrancës dhe rrjedhimisht mosrespektimit të nenit 252 të K.Pr.Penale, sipas të cilit është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi viktimë ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova e materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale. Kjo situatë ka sjellë që liria e këtyre shtetasve të kufizohet në mënyrë jo të përligjur me standartet dhe garancitë ligjore-procedurale.

Vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar gjithashtu mangësi në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit dhe regjistrat e kqyruar, të cilat janë detyrime ligjore që garantojnë respektimin e të drejtave të protestuesve të shoqëruar dhe të ndaluar në ambientet e policisë dhe në mënyrë të veçantë, të drejtës për tubim dhe të drejtës për liri dhe siguri. Për dy prej shtetasve të akomoduar për 24 orë në Komisariatin e Policisë nr.3, në cilësinë e të arrestuarve në flagrancë, vëzhguesit e KShH-së vërejtën mosrespektim të detyrimeve të parashikuara në nenin 34/b, gërma ç) të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nënligjore, sipas të cilave, autoritetet e policisë kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme, sa më shpejtë të jetë e mundur, por jo më vonë se 12 orë nga momenti



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

i ndalimit/arrestimit, për nënshtrimin e shtetasve ndaj kontrollit ose vizitës mjekësore të specializuar.

Nga kqyrja pamore e realizuar në dhomat e sigurisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatit të Policisë nr. 5 (Kamëz) u konstatuan kushte shumë të vështira higjieno-sanitare, dhe jo të përshtatshme sa i përket mungesës së ajrimit, mungesës së dritës natyrale, mungesës së sistemit të ngrohjes, etj.

KShH tërheq vëmendjen për mosrespektimin e kuadrit ligjor dhe standarteve ndërkombëtare sa i takon procedurës së dokumentimit të shenjave të dëmtimit fizik nga stafi mjekësor dhe moskallëzimit në prokurori, në ato raste kur shtetasit e arrestuar në flagrancë apo të ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit pretendojnë se këto dëmtime janë krijuar nga ushtrimi i dhunës së punonjësve të policisë. Këto garanci janë të nevojshme, për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm dhe objektiv, se personi i është nënshtruar formave ushtrimit të dhunës, me elementë të trajtimit ç'njerëzor dhe degradues që ndalohen nga neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në media është raportuar arrestimi nga ana e punonjësve të policisë pranë Komisarariatit nr. 1 Tiranë, të një qytetari me probleme të shëndetit mendor. Sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pika 1, gërma “e”, edhe një shtetasi me probleme të shëndetit mendor mund t'i kufizohet liria, në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj. Megjithatë, referuar praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në çdo fazë të kufizimit të lirisë, duke përfshirë këtu edhe veprimet e kufizimit paraprak të lirisë që ndërmerren nga policia (derisa vlerësohen nga një autoritet gjyqësor), e drejta për liri dhe siguri do të cenohej, nëse individi me çrregullime të shëndetit mendor do të vendosej në një mjedis jo të përshtatshëm terapeutik.

## **I. Intervistat me përfaqësuesit e institucioneve të monitoruara**

Pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, vëzhguesit e KShH-së morën takim me Drejtorin, Z. Florenc Panganika, sipas të cilit, gjatë datave 9-10 Mars 2022, Policia e Tiranës ka shoqëruar në zbatim të nenit 109 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”<sup>1</sup>, 64 shtetas, nga të cilët 32 janë proceduar në gjendje të lirë.<sup>2</sup> Gjithashtu, u referua se, janë arrestuar në flagrancë në zbatim të neneve 251 e vijues të K.Pr.Penale, 49 shtetas nga punonjësit e policisë pranë Komisarariatit nr. 1, Komisarariatit nr. 2 dhe Komisarariatit nr. 3, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, përkatësisht nga nenet 262 “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme”, neni 274 “Prishja e qetësisë publike”, neni 293 “Pëngimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe neni 236 “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”.

<sup>1</sup> Përditësuar nëpërmjet vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 5.7.2021. Link: <https://qbz.gov.al/previeë/e830b488-3631-4ca7-ab49-f640396cf9b5/cons/20210811>

<sup>2</sup> Në datën 9 Mars, në total, janë shoqëruar nga Policia e Tiranës 15 qytetarë nga të cilët 9 u proceduan më pas në gjendje të lirë. Në datën 10 Mars u shoqëruan nga punonjësit e policisë së shtetit 49 qytetarë nga të cilët 23 qytetarë janë proceduar në gjendje të lirë.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Komisariati i Policisë nr. 1	7 qytetarë janë arrestuar në flagrancë
Komisariati i Policisë nr. 2	17 qytetarë janë arrestuar në flagrancë
Komisariati i Policisë nr. 3	25 qytetarë janë arrestuar në flagrancë

Sipas përfaqësuesve të Policisë së Shtetit, protesta në përgjithësi ka reflektuar një klimë të qetë dhe paqësore, me përjashtim të disa rasteve të qytetarëve që kanë reaguuar në mënyrë të dhunshme. Gjatë protestave të mbajtura më dt. 9-10 Mars 2022, raportohet se nuk është regjistruar asnjë incident, që të ketë sjellë pasojë në shëndetin apo jetën e efektivëve prezentë të Policisë së Shtetit.

Pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3, vëzhguesit e KShH-së ndërmorën takim me punonjësën e policisë Z. Haxhi Blloku, me detyrë ndihmës specialist i informacionit. Informacioni i marrë pranë këtij Komisaritati nuk rezultoi i njëjtë me informacionin e marrë në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit. Në dt. 9 Mars 2022, në ambientet e Komisarariatit nr. 3 janë shoqëruar 9 persona dhe 5 persona rezultojnë të arrestuar, ndërsa në datën 10 Mars 2022 janë shoqëruar pranë këtij komisaritati 15 qytetarë dhe 4 persona janë arrestuar në flagrancë. Pra numri i shtetasve të arrestuar në flagrancë, rezulton më i lartë se ai i referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë.

Nga takimi i realizuar me shefin e Komisarariatit të Policisë nr. 5 (Kamëz), Z. Oligert Torba, u informuam se nga punonjësit e policisë të këtij komisaritati nuk është ndërmarrë asnjë procedurë shoqërimi, ndalimi ose arrestimi për ngjarje të lidhura me protestën në Tiranë. Më tej, në ambientet e Komisarariatit u identifikuan 5 qytetarë të arrestuar në flagrancë të akomoduar, procedurat ndaj të cilëve ishin realizuar nga stafi i komisariateve të tjera të policisë. Pavarësisht se cili prej komisariateve i kishte kryer procedurat fillestare të arrestit në flagrancë, u vërejt se të dhënat identifikuese të këtyre shtetasve nuk ishin pasqyruar në “Regjistrin e evidentimit të personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar”, por vetëm tek “Libri i personave të ndaluar dhe arrestuar”.

## II. Verifikimi i procedurave dhe dokumentacionit të administruar në institucionet objekt monitorimi

### 1. Në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë

Gjatë kqyrjes së “Regjistrin të marrjes dhe dorëzimit të personit të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar”, vëzhguesit e KShH-së kanë konstatuar se pas arrestimeve në flagrancë, disa protestues janë transferuar nga punonjësit e policisë së Komisariateve nr. 1, 2 dhe 3, pranë Komisariateve të Policisë Elbasan, Kavajë apo dhe Kamëz. Kjo është argumentuar me mungesën e ambienteve të mjaftueshme të infrastrukturës akomoduese, konkretisht dhomave të sigurisë. Pavarësisht se këto transferime janë të parashikuara në seksionin X të Procedurës Standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”<sup>3</sup>, vëzhguesit e KShH-së vlerësojnë se kjo praktikë duhet të kufizohet vetëm për raste urgjente dhe kur dyshohet për vepra me rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

<sup>3</sup> Miratuar me Urdhërin nr. 925, dt. 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Duke qenë se kjo praktikë është e zbatueshme në mënyrë të përsëritur nga policia e shtetit, në rastet e akomodimit të një numri të lartë protestuesish të ndaluar/arrestuar në flagrancë, vëzhguesit me shqetësim evidentojnë se përligjia e transferimit për shkak të mungesës së hapësirave dhe kushteve të kufizuara infrastrukturore, vështirëson dokumentimin e saktë të veprimeve procedurale që ndërmerren ndaj dhe në ngarkim të këtyre shtetasve, duke rritur premisat për abuzivitet dhe mosrespektim të standarteve procedurale të kërkuara për kufizimin e lirisë, sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

## 1.1 Parregullsitë procedurale në rastet e verifikuara

Shtetasja GJ.B. e gjinisë femër dhe e moshës rreth 28 vjeç u gjend e akomoduar në dhomat e sigurisë së Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nën statusin procedural ‘e arrestuar në flagrancë’. Gjatë kqyrjes së “Regjistrimit të marrjes në dorëzim të personit të shoqëruar” u vërejt se transferimi i kësaj shtetaseje pranë ambienteve të Drejtorisë, ishte realizuar nga Komisariati i Policisë nr. 3, më dt. 10.03.2022, në orën 22.00 të mbrëmjes. Veprimi procedural i arrestit në flagrancë i ishte komunikuar qytetares, tre orë më vonë, në orën 01:00 të mëngjesit të ditës tjetër (11.03.2022). Shkaku i kufizimit të lirisë, i dokumentuar në regjistër rezultonte “protestë/bllokim rruge”. Referuar procesverbalit të arrestimit në flagrancë të përpiluar 2 orë e gjysëm pas shoqërimit, më dt. 11.03.2022, në orën 00:45, evidentohet se qytetarja dyshohej si autore e veprave penale të parashikuara nga neni 262 i Kodit Penal “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme”, neni 274 i Kodit Penal “Prishja e qetësisë publike”, neni 293 i Kodit Penal “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit” dhe neni 236 i Kodit Penal “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” të kryera në bashkëpunim. Kjo shtetase ishte e vetmja e gjinisë femër nga gjithë protestuesit e shoqëruar apo që ju ishte komunikuar arrestimi në flagrancë, të cilët mbaheshin të akomoduar në dhomat e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë apo Komisariateve të Tiranës, deri në momentin e zhvillimit të këtij monitorimi. Së bashku me të (në të njëjtën ditë dhe orë) ishte shoqëruar edhe një protestuese tjetër e gjinisë femëror, M.M, me profesion gazetare, e cila ishte lënë e lirë rreth 3 orë më pas.

**Vlen të theksohet se për të dy rastet e mësipërme, punonjësit e policisë nuk kanë respektuar rregullat e përgjithshme të parashikuara në pikën 2.2 (seksioni X) të Urdhërit nr. 925, dt. 18.07.2019,<sup>4</sup> ku parashikohet transferimi vetëm gjatë ditës (pas lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij). Në këndvështrimin e KShH-së, urgjenca në ndërmarrjen e këtij transferimi nuk është e përligjur.**

Pas marrjes së takimit me protestuesen GJ.B., vëzhguesit e KShH-së konstatuan se asaj nuk i është vendosur në dispozicion kopja e procesverbalit të veprimeve të kryera me të, gjatë fazës

---

<sup>4</sup> Sipas kësaj dispozite parashikohet: “Shoqërimi i të arrestuarve/ndaluarve në çdo rast bëhet vetëm gjatë ditës (pas lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij). Në raste të defekteve të automjeteve, avarive dhe të papriturave të tjera, vendosja dhe sigurimi tyre bëhet përkohësisht në komisariatit e policisë më të afërt. Në këtë rast vihet në dijeni menjëherë Shërbimi Sallës Komandimit, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit”.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

procedurale të shoqërimit, në cënim të së drejtës procedurale të parashikuar në nenin 109, pika 5 e ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”<sup>5</sup>. Procesverbali mungonte edhe në dosjen personale të shtetases, të transferuar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Bazuar në nenin 255 të Kodit të Procedurës Penale, Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që kanë kryer një arrestim ose ndalim ose kanë marrë në dorëzim të arrestuarin, informojnë menjëherë personin e arrestuar për arsyet e arrestimit ose ndalimit dhe për të drejtat e tij, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar (në referencë edhe të nenit 34/b, të këtij Kodi). Protestuesja Gj.B pretendoi se kjo letër nuk i është bërë me dije, por nga verifikimi i dosjes personale u konstatua se letra e të drejtave është nënshkruar nga shtetasja por edhe mbrojtësi i saj ligjor. Vëzhguesit e KShH-së, me profil jurist nuk mund të verifikonin saktësinë e origjinalitetit të nënshkrimeve pasi nuk janë ekspertë të fushës përkatëse.

Praktika e dokumentacionit e prodhuar nga sistemi TIMS dhe ajo që pasqyrore gjurmët daktiloskopike, shoqëruar me kartëlen e materialeve procedurale të dorëzuara për dosjen e të ndaluarit/arrestuarit, shfaqte parregullsi formale, për shkak se nuk reflektonte të shënuar datën e hartimit, numrin rendor përmbyllës të listës së dokumentacionit, si dhe është nënshkruar në mënyrë të pjesshme vetëm nga punonjësit përgjegjës të policisë.

Vëzhguesit e KShH-së u njohën me pretendimin e shtetases së arrestuar në flagrancë GJ.B, se gjatë shoqërimit, ndaj saj janë kryer veprime të dhunshme nga punonjësit e policisë. Vlen të theksohet se vëzhguesit e KShH-së nuk janë ekspertë në fushën e mjekësisë ligjore, mgjth, nga kqyrja pamore u evidentuan shenja të dukshme, gërvishtje dhe shenja të tjera në pjesën e parakrahut. Kjo shtetase referoi se kishte marrë trajtimin e nevojshëm mjekësor nga mjeku në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Konstatimi i shenjave të dëmtimit fizik në pjesën e parakrahut ishte dokumentuar në procesverbalin e konstatimit të përpiluar nga mjeku, në orën 01:30, dt. 11.03.2022, si dhe në Librin e Vizitave Mjekësore (nr.rendor 473). **Nga kqyrja e dosjes personale të kësaj shtetaseje, u vërejt se mungonte kartela mjekësore me shënimet përkatëse të mjekut<sup>6</sup>.**

**KShH tërheq vëmendjen për mosrespektimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standarteve ndërkombëtare sa i takon procedurës së dokumentimit të shenjave të dëmtimit fizik nga stafi mjekësor dhe moskallëzimit në prokurori, kur shtetasit e arrestuar në flagrancë apo të ndaluar në ambientet e dhomave të sigurisë të Policisë së Shtetit pretendojnë se këto dëmtime janë krijuar nga ushtrimi i dhunës së punonjësve të policisë.** Komiteti për Parandalimin e Torturës i Këshillit të Evropës (KPT), në raportin e tij periodik të publikuar në vitin 2019 ka konstatuar mungesën e ndërgjegjësimit të stafit mjekësor të institucioneve të kufizimit të lirisë,

<sup>5</sup> Si dhe neni 1, gërma f), kapitulli VII, të Procedurës standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhër, nr 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>6</sup> Bazuar në gërmën “h” të nenit 10 të Kapitullit V të Rregullores për “Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë ankesave të tyre”, të miratuar me Urdhërin 925 datë 18.07.2019, kjo kartelë mjekësore duhet të disponohej në dosjen e personit të arrestuar.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mbi detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 282 K.Pr.Penale, për të kallëzuar pranë organit procedues rrethanën e konstatuar.<sup>7</sup> Në dritën e gjetjeve të këtij raporti, i cili vijon të jetë aktual edhe për konstatimet e vërejtura gjatë monitorimit të KShH-së në çështjen në fjalë, përcillet shqetësimi se shtetasit e ndaluar/arrestuar nuk i nënshtrohen në mënyrë sistematike kontrollit mjekësor në ambientet e dhomave të policisë, se kontrole të tilla kufizohen me pyetje të natyrës së përgjithshme nga stafi mjekësor, në prezencën e punonjësve të policisë dhe nuk përfshijnë ekzaminimin mjekësor (shih faqen 4 të raportit, footnote 7).

Në të njëjtat kushte me protestuesen e arrestuar në flagrancë, GJ.B, pranë dhomave të sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, vëzhguesit e KShH-së morën takim edhe me 4 protestues të tjerë, të arrestuar në flagrancë (V.P, E.L, A.Z dhe S.RR). Veprimet ndaj tyre ishin realizuar nga punonjësit e policisë së Komisarariatit nr.3. Asnjë prej këtyre shtetasve nuk dispononte kopje të procesverbalit të ndalimit/arrestimit, kontrollit personal dhe kopje të deklaratës së të drejtave. **Këto parregullsi cenojnë të drejtat procedurale të shtetasve të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë, e cila gëzon mbrojtje në nenin 28 të Kushtetutës, nenin 5 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nenin 34/b të Kodit të Procedurës Penale, si dhe legjislacionin kuadër të policisë së shtetit (duke përfshirë aktet e dala në zbatim të tij)**<sup>8</sup>.

## 2. Komisarati i Policisë nr. 3 (Tiranë)

### 2.1 Shoqërimi i dy shtetasve të mitur

Vëzhguesit e KShH-së konstatuan nga kqyrja e dokumentacionit, prezencën e dy shtetasve të mitur, të akomoduar pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3 (Tiranë). Nga verifikimet në “Regjistrin për evidentimin e shtetasve të shoqëruar ose ndaluar/arrestuar”, shtetasit e mitur E.B, dhe E.S, të moshës 17 vjeç rezultojnë se janë shoqëruar më dt. 10.03.2022, në orën 20:30, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal, “Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit”. Në këtë regjistër mungonte shënimi për të dhënat e kontaktit dhe orën e njoftimit të familjarëve për shtetasin e mitur E.S<sup>9</sup>, ndërkohë që për shtetasin E.B, familjarët ishin njoftuar në orën 21:00, pra rreth 30 min’ pas akomodimit në institucion<sup>10</sup>. Të dy shtetasit e mitur janë mbajtur në këtë Komisarjat për afro një orë e gjysëm dhe janë lënë të lirë rreth orës 22:00 të datës 10.03.2022.

## 3. Komisarati i Policisë nr. 5, Kamëz

<sup>7</sup> CPT/Inf (2019) 28, pika 23, f. 19. Link: <https://rm.coe.int/168097986b>

<sup>8</sup> Neni 1, pika 1.11, kap.VI të Rregullores për “Trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë ankesave të tyre”, të miratuar me Urdhërin 925 datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>9</sup> Për shtetasin E.S kishte vetëm një shënim “njoftuar”, pa dhënë informacion më të detajuar për këtë pjesë, lidhur me personin e njoftuar

<sup>10</sup> Kjo procedurë njoftimi e verifikuar në rastin e këtij shtetasi është në përputhje me afatin maksimal 3 orë të parashikuar në pikën 1, gërma k), seksioni VII të Procedurave Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.





# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nga monitorimi i realizuar në ambientet e Komisarariatit të Policisë nr. 5, Kamëz, vëzhguesit e KShH-së morën takim me 5 protestues të cilëve j'u ishte kufizuar liria (G.T., R.M., E.A., A.N., dhe B.L). Këta shtetas mbaheshin në cilësinë e personave të arrestuar në flagrancë.

Nga verifikimi i formularëve të raporteve<sup>11</sup> dhe praktikës së dokumentacionit të administruar për shtetasit G.T.<sup>12</sup> dhe R.M.<sup>13</sup>, u konstatua se nuk ishte hapur kartelë shëndetësore ndaj tyre. Punonjësit përgjegjës për administrimin e informacionit i komunikuan vëzhguesve se janë në pritje të mjekut për realizimin e evidencave përkatëse mjekësore. Tërheq vëmendjen fakti se këta shtetas kishin më shumë se 24 orë të akomoduar në këtë institucion, nën statusin procedural, shtetas të arrestuar në flagrancë. **Bazuar në nenin 34/b, gërma ç) të Kodit të Procedurës Penale dhe aktet nënligjore<sup>14</sup>, autoritetet e policisë<sup>15</sup> kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme, sa më shpejtë të ishte e mundur, por jo më vonë se 12 orë nga momenti i ndalimit/arrestimit për nënshkrimin e shtetasve ndaj kontrollit ose vizitës mjekësore të specializuar.**

Gjithashtu, edhe gjatë intervistimit të shtetasve E.A., A.N dhe B.L., u pretendua se nuk i janë nënshtruar asnjë kontrolli/vizite mjekësore. Në dosjen e tyre personale, vëzhguesit e KShH-së evidentuan ekzistencën e kartelave shëndetësore individuale të plotësuara dhe nënshkruara nga ana e mjekut pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3 (Tiranë).<sup>16</sup>

### III. Kushtet e akomodimit në ambientet e Institucioneve të monitoruara

Nga kqyrja pamore e realizuar në dhomat e sigurisë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatit të Policisë nr. 5 (Kamëz) u konstatuan kushte shumë të vështira higjieno-sanitare, dhe jo të përshtatshme sa i përket mungesës së ajrimit, mungesës së dritës natyrale, mungesës së sistemit të ngrohjes, etj.

Nga intervistimet me shtetasit e arrestuar në flagrancë prezent gjatë momentit të monitorimit, u pretendua se brenda dhomës së sigurisë në Drejtorinë e Policisë Vendore Tiranë janë vendosur të qëndrojnë 11 shtetas. Nga intervista me shtetasen G.J.B., u pretendua se më dt. 10.03.2022, gjatë qëndrimit në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, në mungesë të një krevati ishte vendosur për të fjetur në një shtresë sfungjeri, të shtruar mbi pllaka. Kjo e dhënë u konfirmua nga

<sup>11</sup> Të shoqërimit ose ndalimit/arrestimit.

<sup>12</sup> Praktika dokumentative e verifikuar në rastin e shtetasit G.T., përmban: Procesverbal i arrestimit në flagrancë; Dokument identifikimi i personit të arrestuar në flagrancë; Procesverbal kontrolli i personit të arrestuar në flagrancë; Karta e të drejtave; Të dhëna identifikuese nga sistemi Tims

<sup>13</sup> Praktika dokumentative e verifikuar në rastin e shtetasit R.M., përmban: Karta e të drejtave; Procesverbal arrestimi në flagrancë; Procesverbal i kontrollit personal dhe Dokument identifikimi i personit të arrestuar në flagrancë

<sup>14</sup> Pika 7.2, neni 7, kapitulli IV, i Rregullores “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimin dhe zgjidhjen e kërkesë/ankesave të tyre”, të miratuar nëpërmjet urdhërit nr. 925/2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

<sup>15</sup> Komisarati i Policisë nr. 3 (institucioni fillestar që ka ekzekutuar shoqërimin e këtyre shtetasve).

<sup>16</sup> Konkretisht për qytetarin A.N., kartela mjekësore mbante numër rendor 760, për shtetasin B.L me numër rendor 761 dhe për shtetasin E.A me numër rendor 762.



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

punonjësit e policisë prezentë në momentin e monitorimit, sipas të cilëve shtetasja ishte akomoduar së bashku me një tjetër qytetare të së njëjtës gjini në dhomën, në të cilën gjendej vetëm 1 krevat.

Bazuar në këto fakte, KShH vëren se ndaj shtetasve të arrestuar në flagrancë nuk janë garantuar kushte akomodimi pranë dhomave të sigurisë, të cilat respektojnë dinjitetin dhe trajtimin njerëzor të tyre<sup>17</sup>.

#### IV. Monitorimi online i medias

Liria e tubimit paqësor merr rëndësi të veçantë në një shtet ligjor dhe demokratik. NENI 11 I Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është ratifikuar nga vendi ynë garanton lirinë e tubimit dhe të organizimit. Sipas këtij neni, çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët. Ushtrimi i kësaj të drejte nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

Gjatë monitorimit online rastësor të portaleve të ndryshme, medias televizive si dhe medias së shkruar, ekipi i KShH-së ka konstatuar se gjatë protestave ku kundërshtohet rritja e çmimeve, janë dhënë edhe pamje filmike/regjistrime, të cilat pasqyrojnë përplasje fizike ndërmjet protestuesve dhe punonjësve të Policisë së Shtetit, në momentet e bllokimit të akseve rrugore.<sup>18</sup> Në përballjen me forcën e ligjit, të referuar nga ana e Policisë së Shtetit,<sup>19</sup> sipas medias janë prekur edhe vetë punonjësit e medias dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.<sup>20</sup>

Në nenin 133 të ligjit nr. 118/2019 “Për Policinë e Shtetit” janë parashikuar kushtet dhe kriteret konkrete të cilat duhet të respektohen nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, në rastet e përdorimit të forcës për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme, dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Punonjësi i policisë duhet gjithashtu të përdorë forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke paralajmëruar se do të përdorë forcën përpara përdorimit të saj. Nga pamjet filmike të bëra publike në media arrihet të provohen paralajmërimet e bëra nga ana e punonjësve të policisë duke u bërë thirrje qytetarëve për të liruar akset rrugore, por përdorimi i forcës duke marrë në konsideratë numrin e lartë të punonjësve të policisë dhe numrin më të ulët të protestuesve, nuk duket të ketë qënë proporcional, në përputhje me parimet e domosdoshmërisë dhe përgjegjshmërisë.<sup>21</sup>

<sup>17</sup> Në cënim të nenit 4 të Procedurës Standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” të miratuar me Urdhërin nr. 938/2019, si dhe pikës 1.15, nenin 1, kap. VI të Rregullores “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë ankesave të tyre”, të miratuar me Urdhërin 925/2019.

<sup>18</sup> [https://ëëë.instagram.com/tv/Ca72Z7SqB8E/?utm\\_medium=copy\\_link](https://ëëë.instagram.com/tv/Ca72Z7SqB8E/?utm_medium=copy_link)  
[https://ëëë.instagram.com/tv/CbC4Pxnouxk/?utm\\_medium=copy\\_link](https://ëëë.instagram.com/tv/CbC4Pxnouxk/?utm_medium=copy_link)

<sup>19</sup> <https://ëëë.facebook.com/policiashtetitshqiptar/posts/3288024948150520>

<sup>20</sup> <https://citizens-channel.com/2022/03/10/protestat-kunder-rritjes-se-cmimeve-dhune-policore-dhe-arrestime/>

<sup>21</sup> <https://ëëë.youtube.com/ëatch?app=desktop&v=dXTpx8ocOGc>



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

## ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Në kuadër të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit, forca si një mjet shtrëngues përjashtimor mund të përdoret ndaj individit, i cili përdor forcë kundër-drejtuese, ose për të shmangur një kërcënim të afërt.<sup>22</sup> Nga lajmet e publikuara në media ka rezultuar se kundër-veprim me përdorim të forcës ka pasur edhe nga qytetarët, kryesisht protestues të moshave të reja.<sup>23</sup> Duke qenë se media publikon sekuenca shpesh herë të shkurtra të situatave të ndodhura, të cilat pamundësojnë gjurmimin dhe fiksimin e pamjeve nga kohë kur fillon përplasja, si zhvillohet dhe si përfundon ajo, KShH nuk mund të vlerësojë objektivisht, proporcionalitetin e veprimeve të ndërmarra nga punonjësit e Policisë. Mgjth është e nevojshme të theksohet se një një situatë të tillë, në frymën e të drejtës për një tubim paqësor, të ruhet nga çdo protestues qetësia, të respektohen autoritetet ligjzbatuese dhe misioni që ato kanë për ruajtjen e rendit publik, dhe punonjësit e policisë së shtetit kanë detyrimin të respektojnë të drejtën e tubimit dhe garancitë procedurale nëse liria e një shtetasi kufizohet vetëm dhe në përputhje me ligjin.

Në media është raportuar gjithashtu edhe arrestimi nga ana e punonjësve të policisë pranë Komisarariatit nr. 1 Tiranë, të një qytetari me probleme të shëndetit mendor.<sup>24</sup> Lidhur me këtë çështje, vlen të theksohet se sipas nenit 5 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pika 1, gërma “e”, edhe një shtetasi me probleme të shëndetit mendor mund t’i kufizohet liria, në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj. E njëjta frymë është reflektuar nga neni 27, pika 2, gërma d) e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, standardet ndërkombëtare inkurajojnë me forcë mos përdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjyqimit penal, deri në dhënien e vendimit. Vlen të qartësohet se masat shtrënguese i takojnë një faze të mëvonshme të procesit dhe vendosen vetëm nga një autoritet gjyqësor. Megjithatë, referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në çdo fazë të kufizimit të lirisë, duke përfshirë këtu edhe veprimet e kufizimit që ndërmerren nga policia, e drejta për liri dhe siguri do të ishte e papranueshme, nëse do të kufizohej liria e një individi me çrregullime të shëndetit mendor, në një mjedis jo të përshtatshëm terapeutik<sup>25</sup>.

---

<sup>22</sup> [http://freeassembly.net/ep-content/uploads/2016/02/A.HRC\\_31.66\\_E\\_ëith\\_addendum.pdf](http://freeassembly.net/ep-content/uploads/2016/02/A.HRC_31.66_E_ëith_addendum.pdf)

<sup>23</sup> <https://ëëë.oraneës.tv/vendi/pershkallezohet-protesta-ne-durres-te-rinjte-cajne-kordonin-e-policise-i1033477>

<sup>24</sup> <https://lapsi.al/2022/03/13/policia-e-tiranes-prangosi-ne-proteste-nje-person-me-aftesi-ndryshe-u-mbajt-4-dite-ne-geli/>

Nga një artikull i publikuar në median elektronike rezulton se Gjykata e ka vleftësuar të ligjshëm ndalimin e këtij shtetasi, ndërkohë që ka vendosur lirimin e menjëhershëm të tij, duke mos caktuar asnjë masë sigurimi në ngarkim të tij.

<sup>25</sup> Çështja *Hutchison Reid v. the United Kingdom*, 50272/99, 20.02.2003.



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

---

Adresa: Rr. "Brigada e VIII", Pall TeknoProjekt  
Ap.10, Kati 5 Tirana-Albania  
P. O. Box /Kutia Postare No. 1752

Tel & Fax: ++355 (0)4 233671  
e-mail: [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)  
web address: [www.ahc.org.al](http://www.ahc.org.al)